VENDIM
Nr. 437, datë 18.7.2018

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 115, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DISIPLINORE DHE TË RREGULLAVE PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN E VENDIMMARRJEN NË KOMISIONIN DISIPLINOR NË SHËRBIMIN CIVIL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 59, pika 10, e 69, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

Në kreun II, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"6/1 Përjashtimisht, për rastet kur shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion, kërkesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, i dërgohet komisionit disiplinor.".

2. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1 Komisioni disiplinor, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, sipas pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi, e vlerëson paraprakisht atë. Nëse nga vlerësimi i informacionit të marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, komisioni disiplinor vendos të mos e fillojë ecurinë disiplinore.".

3. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1 Në rast se nga informacioni i marrë, sipas pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi, rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, komisioni disiplinor bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar. Në rast se nga vlerësimi rezulton se:

a) Shkelja klasifikohet në shkeljet e rënda apo shumë të rënda, komisioni disiplinor fillon ecurinë disiplinore;

b) Shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, komisioni disiplinor i kërkon eprorit direkt të fillojë ecurinë disiplinore.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama